



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 11, QARKU KUKËS, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 22.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 11, Qarku Kukës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

**V Ë R E N**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin:

- nr. 351 datë 15.05.2019, ka miratuar caktimin e VNV së KZAZ nr. 11 në Shkollën e Mesme "Havzi Nela", palestra me sipërfaqe 300 m2, Bashkia Kukës.

Prefekti i Qarkut Kukës, me shkresën nr. 12008 prot., datë 21.06.2019, në ushtrim të përgjegjësisë, bazuar në përcaktimet e ligjit 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", kërkesës së Bashkisë Kukës, propozon ndryshimin e vendndodhjes të:



**Nr. 855 i Vendimit    Data 22.06.2019 e Vendimit    Ora 12:00 e Vendimit**

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të ZAZ-ve nr. 11, Qarku Kukës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

- VNV-së së ZAZ nr. 11 nga Shkolla e Mesme "Havzi Nela", Bashkia Kukës, në ambientet "Bufe Verandë" e ish hotel Drinit, me sipërfaqe 164 m2.

Kryetari i Bashkisë Kukës, i ka bërë publike kërkesën për lirim të ambientit në përgjegjësi administrimi, ambient ku administrata zgjedhore, KZAZ-së nr. 11, ushtron funksionin publik për përgatitjen e procesit zgjedhor të datës 30.06.2019, kërkesë e adresuar shkresërisht edhe në KQZ.

Propozimi dhe objekti i paraqitur nga Prefekti i Qarkut Kukës, plotëson përafërsisht kushtet e përcaktuara në Udhëzimin e KQZ nr. 4, datë 09.04.2015 "Për mënyrën e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të Grupeve të Numërimit për çdo Vend të Numërimit të Votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit", pasi sipërfaqja e ambientit prej 164 m2, është më e vogël se ajo e kërkuar. Në vlerësim të pamundësisë për një objekt me sipërfaqe më të madhe, objekti i propozuar mbetet e vetmja alternativë në Bashkinë Kukës për të shërbyer si VNV e ZAZ nr. 11.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

### **V E N D O S I**

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 11, në ambientet "Bufe Verandë" e ish Hotel Drinit, me sipërfaqe 164 m2, Kukës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 855 i Vendimit    Data 22.06.2019 e Vendimit    Ora 12:00 e Vendimit**

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të ZAZ-ve nr. 11, Qarku Kukës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019